



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra /Kabinet of the Minister

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Nivelo org. Org. Jedinica Org. Unit	M-01	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	3235/22
Nr. i Faqeve Br. Stranica No Pages	6	Data: Datum: Date:	03.06.22
PRISHTINË / A			No. 1

Data: 03/06/2022

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) – Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, nenin 159 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, pikës 1 dhe 9 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/50 i datës 23/12/2021 për miratimin e analizës juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat dhe rekomandimit me nr. rendor 461 të dhënë në Shtojcë 1 të këtij Vendimi, nxjerr:

V E N D I M

1. Për organizimin, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura.
2. Provimit profesional i nënshtrohet punonjësi i Drejtorive për Administrimin e Zonave të Mbrojtura (këtu e tutje Drejtoria) i cili ka së paku përgatitjen e mesme profesionale dhe tre (3) muaj përvojë pune në Drejtori.
3. Njohuritë dhe përgatitja e kandidatit vlerësohen nga Komisioni për Organizimin e Provimit Profesional (këtu e tutje Komisioni) i cili emërohet me Vendim të Ministrit me mandat dy (2) vjeçar.
4. Komisioni përbehet nga tre (3) anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre duhet të kanë të paktën kualifikim superior dhe pesë (5) vite përvojë në fushën e mbrojtjes së natyrës.
5. Drejtoria e cakton Udhëheqësin për përcjelljen e punëve përgatitore rreth dhënies së provimit profesional i cili në bashkëpunim me Komisionin mund të organizojë forma të veçanta të ndihmës profesionale trajnime, seminare.
6. Provimi përbehet nga pjesa e përgjithshme dhe pjesa e veçantë. Provimi organizohet me shkrim, kandidatet të cilët arrijnë mbi 50% të pikëve i nënshtrohen intervistës me gojë.

7. Vendi dhe data e mbajtjes së provimit caktohet nga Komisionit dhe publikohet në web faqen zyrtare të Ministrisë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së provimit.
8. Aplikuesi paraqet provimin profesional në Ministri duke plotësuar formularin e aplikimit.
9. Mbulimi i shpenzimeve për organizimin e provimit për aplikuesit bëhet nga buxheti i Ministrisë.
10. Aplikuesi mund të tërhiqet nga nënshtrimi provimit të paraqitur, por duhet ta njoftojë Komisionin jo më vonë se tetë (8) ditë para afatit të mbajtjes së provimit.
11. Komisioni siguron mbarëvajtjen e provimit dhe për rezultatet përgatit Procesverbal i cili përmban: datën dhe vendin e mbajtjes së provimit, përbërjen e Komisionit, të dhënat e kandidatëve, rezultatet e testit me shkrim dhe suksesin e përgjithshëm të provimit. Procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
12. Suksesi i kandidatit në provim vlerësohet me vlerësimin "i suksesshëm" ose "i pasuksesshëm".
13. Çdo kandidat ka të drejtë më së shumti tri (3) herë t'i nënshtrohet provimit.
14. Lista e temave të provimit profesional është përcaktuar në Shtojcën 1 të këtij Vendimi .
15. Formulari i aplikimit për provim profesional është përcaktuar në Shtojcën 2 të këtij Vendimi.
16. Forma e Certifikatës mbi dhënien e provimit është përcaktuar në Shtojcën 3 të këtij Vendimi.
17. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë, pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit të MMPHI-së .

Liburn Aliu
Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës



SHTOJCA 1

LISTA E TEMAVE TË PROVIMIT PROFESIONAL

PJESA E PERGJITHSHME

1. Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës dhe në veçanti të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësit të natyrës dhe baza e mbikëqyrjes inspektuese.
2. Ligji Nr.05/L-087 për Kundërvajtje:
Kapitulli I - Dispozitat Themelore;
Kapitulli II - Përgjegjësia Kundërvajtëse;
Kapitulli V - Masat e Veçanta të Kundërvajtjes;
Kapitulli VI - Të Dhënat nga Evidenca e Kundërvajtjes;
Kapitulli XIII - I Pandehuri dhe i Dëmtuari në Procedurë në Gjykatë;
Kapitulli XVIII - Fillimi dhe Rrjedhimi i Procedurës së Kundërvajtjes; dhe
Kapitulli XX - Pyetja e Dëshmitarit.
3. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës:
Kapitullin II, Veprat Penale dhe Përgjegjësia Penale,
Kapitullin XXVII, Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore; dhe
Kapitulli VII, Konfiskimi i Instrumentalitetit dhe Dobisë Pasurore të Veprave Penale.
4. Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale:
Kapitullin VIII - Detyrimet e Organeve Publike; dhe
Kapitulli IX - Fillimi i Hetimeve dhe Procedura Penale.
5. Njohja bazë e ligjeve të tjera lidhur me mbrojtjen e natyrës në pjesën që lidhet me zonat e mbrojtura të natyrës dhe mbikëqyrjen:
Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës;
Ligji Nr. 04/L -012 për Mbrojtjen nga Zjarri;
Ligji Nr.04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
Ligji Nr. 04/L- 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri";
Ligji Nr. 03/L - 025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
Ligji Nr. 04/L- 147 për Ujërat e Republikës së Kosovës;
Ligji Nr. 04/L- 060 për Mbeturina.
6. Njohja bazë e konventave ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës:
Konventa për Biodiversitetin;
Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare në Specie të Rrezikuara të Faunës dhe Florës;
Konventa për Ruajtjen e Llojeve Migratore të Kafshëve të Egra;
Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore;
Konventa për Ligatinat e Rëndësisë Ndërkombëtare;
Konventa Ramsar;
Konventa e Bernës;
Konventa e Peizazheve;

Konventa e Arhusit.

7. Njohuri bazike për Rrjetin Ekologjik Natura 2000;

PJESA E VEÇANTË

1. Rregulloren për rendin e brendshëm të parqeve kombëtare;
2. Specifikat e zonës së mbrojtur për të cilën aplikohet provimi pranues;
3. Njohuritë e përgjithshme për zonat e mbrojtura dhe vlerave të tjera të mbrojtura të natyrës.

SHTOJCA 2
FORMULARI I APLIKIMIT PËR NËNSHTRIM PROVIMIT PROFESIONAL PËR
MBIKËQYRËS TË ZONA VE TË MBROJTURA

Emri, mbiemri dhe emri i prindit	
Data dhe vendi i lindjes	
Vendbanimi i përhershëm	
Vendbanimi i përkohshëm	
Titulli dhe përgatitja profesionale	
Vendi i punës dhe Drejtoria	
Telefoni	
Email adresa	

Me nënshkrimin e këtij formulari jam i/e pajtimit që të dhënat të cilat janë dhënë në këtë formular të përdoren për nevoja të mbajtjes së evidencës mbi Certifikatat e lëshuara mbi dhënien e provimeve profesionale të mbikëqyrësve.

Data:

Nënshkrimi i Kandidatit:

Pajtimi Drejtorit të Drejtorisë:

SHTOJCA•3
FORMA E CERTIFIKATËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Kabinet of the Minister*

Datë _____

Nr. _____

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, nenin 159 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, si dhe Vendimit _____, lëshon,

ÇERTIFIKATË

mbi dhënien me sukses të provimit profesional të mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura

Emri dhe Mbiemri

I/e _____ lindur më: _____ në _____ me datën: _____ e ka dhënë Provimin Profesional për Mbikëqyrës me çka e ka fituar të drejtën e ushtrimit të detyrave të punës së të Mbikëqyrësit në Drejtorinë për Administrimin e Zonës së Mbrojtur.

Prishtinë

V.V.

Ministri